



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2023:255136

Datë: 16.12.2024

Numri i dokumentit: 06601667

C.nr.989/2023

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E. G., nga J., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B. Sh., avokat në P., kundër të paditurës Komuna e Junikut, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqësojnë N.S., F.L. dhe S.B., avokatë në P. si dhe juristet A. A, dhe U. R., me seli në P., për shkak të kompensimit mbi bazën e kualifikimit, me vlerë të kontestit 4.012,68 €, jashtë seance, me datë 16.12.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses E. G. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Junikut, Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses në emër të pagesës për diferencë në pagë për shkak të kualifikimit – licencimit, t'i paguaj shumën për periudhën nga data 22.11.2020 e deri më datën 06.02.2023 apo për 26 muaj dhe atë për kualifikim me diplomë universitare në vlerë të 27% nga paga bazë për secilin muaj veç e veç në lartësi prej 78,68 €, e në shumë të përgjithshme prej 2.045,68 €, të gjitha këto brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të aktgjykimit, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë (datë 22.11.2023) e deri në pagesën definitive, e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Junikut, Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 120,00 €, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë në shumë prej 1.967,00 €, si e PABAZUAR.

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësuesit me autorizim, në këtë gjykatë më datë 22.11.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për kompensim të pagës mbi bazën e kualifikimit, e në të cilën padi ka theksuar se paditësja është e punësuar në Sh.F.M.U. “E... H...” në J., respektivisht ka lidhur kontratë pune me të paditurën, me ç’rast paditësja mbanë titullin e punës mësimdhënëse e Gjuhës Angleze. Paditësja është e diplomuar, me diplomë të Universitetit të Prishtinës, Fakultetit i Filologjisë dhe ka gradën Baçelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, gjithashtu paditësja ka licencën e mësimdhënësit të karrierës dhe duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33 të datës 29.08.2008 mësimdhënësve me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar i takon kompensim 27 % e pagës bazë dhe me padi ka kërkuar që paditësja për periudhën nga data 12.11.2018 e deri me datë 06.02.2023, për 51 muaj të kompensohet në shumë të përgjithshme prej 4.012,68 €, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

E paditura përmes përfaqësuesit me autorizim, me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses për nga baza ashtu edhe nga lartësia, për arsye se paditëses nuk i takon kurrfarë diference në pagë sepse i njëjti është duke u paguar konform koeficientit, tutje thekson se kjo kërkesë është vjetërsuar apo parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të Punës ku thuhet se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tre vitesh. Po ashtu pretendojnë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nuk ka karakter imperativ dhe si e tillë e paditura nuk ka kurrfarë obligimi ndaj paditëses, po ashtu kompensimi i tillë nuk është përfshirë as në kapitullin 4 të Kontratës Kolektive në fjalë, po ashtu kompensimi i tillë nuk është paraparë se me Ligjin e Punës, as me Ligjin për Shërbyesit Civil dhe as me Ligjin për Pagat. Dhe si rezultat i kësaj e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore linjë të veçantë për këtë lloj të kompensimit, andaj ka propozuar që të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen E. G., e lëshuar nga Komuna e Junikut, Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në Sh.F.M.U. “E.... H....” në J. , si Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze. Bazuar në Listën e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet fakti se paditësja realizon pagë bazë në lartësi prej 421,00 € dhe në emër të kualifikimit për çdo muaj i është paguar shuma prej 34,99 €, meqenëse e njëjta ka diplomuar me datë 28.05.2012 dhe ka marrë kualifikimin “Baçelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze”, fakt që vërtetohet përmes Diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Filologjisë, Qendra në Prishtinë, me numër 4220 e lëshuar me datë 20.06.2018. Po ashtu paditësja ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës

të karrierës me numër 1028701. Gjykata konform nenit 329 paragrafi 1 të LPK, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023 ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa pika 4 nën-pika 3 e tij, ka përcaktuar se *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%”*. Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, se e njëjta ka diplomë universitare të kryerjes së fakultetit dhe ka kualifikimin bachelor dhe ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 22.11.2020 e deri më datën 06.02.2023 apo për 26 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumën prej 78,68 € për çdo muaj, apo shuma e përgjithshme prej 2.045,68 €, për këtë kriter të kompensimit.

Duke qenë se kjo gjendje faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësja është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën prej datës 22.11.2020 e deri më datën 06.02.2023 të njëjtit nuk i është kompensuar pjesa tjetër e shtesave në emër të kualifikimit prej 78,68 €, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovës, Ligji i Punës, Ligji për Shërbyesit Civil dhe Ligji i Pagave, nuk e kanë paraparë pagesën e kompensimit për kualifikim, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, ky pretendim rezulton i pabazuar sa i përket periudhës prej datës 22.11.2020

e deri më datën 06.02.2023 pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 22.11.2023, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par. 2 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç’rast paditëses iu pranua shumua e shpenzimeve në vlerë prej 120,00 €. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 40,00 €, si dhe për përpilimin e padisë shumua prej 80,00 €.

Sa i përket pjesës refuzuese gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës në lidhje me parashkrimin e pjesshëm të kërkesës, gjykata i morri si të bazuara dhe atë sa i përket periudhës kohore prej datës 12.11.2018 e deri më datën 21.11.2020, me lartësi të kërkesës, për shumën prej 1.967,00 €, pasi që nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësja kërkesën e saj për kompensimin në emër të kualifikimit për periudhën e lartcekur e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj në rastin konkret padia për këtë periudhë kohore është parashtruar me datë 22.11.2023 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për çka gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësja, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.989/23, datë 16.12.2024

Gj y q t a r i

---

Bajram Cacaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.